

VENDIM
Nr. 305, datë 10.4.2013

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS
MUHURR TË QARKUT TË DIBRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave.

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike ,shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Muhurr të qarkut të Dibrës, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Muhurr të qarkut të Dibrës, miratuar me vendimin nr. 760, datë 28.5.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Muhurr të qarkut të Dibrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Muhurr për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha